

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Adresa: Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore, Kati 3-te.

Nr. 86/2 Prot

Shkoder, dt. 10.09.2009

I N F O R M A C I O N

**“MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJORE PERROI I THANES
DHE PERROI I PLLAUT
FSHATI GUR - LURE
PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA
SHOQERIA “ ALBANIAN HYDROPOWER ” A.H.P. sh.p.k.
HEC SETA 2/B ”**

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nge shoqeria “ALBANIA HYDROPOWER ” A.H.P. sh.p.k., per perdorim te burimit uJOR Perroi i Thanës dhe Perroi i Pllaut, per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune, nuk ka te beje me projekte, per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperm vepra e marrjes se ujit, ne te du perrenjte, do te ndertohet ne kuoten 1012 m mbi nivelin e detit, ndersa ndertesa e HEC-it do ndertohet ne kuoten 806 m. Prurja mesatare shume vjecare eshte $Q = 2.1$ m³/sek. Subjekti kerkon te shfrytetoje nje prurje prej $Q = 2.51$ m³/sek.

Subjekti gjate gjithe vitit nuk do pengoje furnizimin me uje te zones.


Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune Shkoder, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 “ PER KONCESIONET ” dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV i V.K.M. nr. 87 dt. 16.01.2008 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007, te KM., “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve “ , te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretari

Xhelal Bajraktari


Kryetari

Maxhid CUNGU


Mora nje informacion komo

dt. 10-09-2009 Shkoder